

*Nanës Arife dhe fëmijëve të mi
për frymëzim e bashkëpunim
si dhe znj. Lirie për ribotimin e kësaj vepre*



S q a r i m :

Përmbledhja "Miklime" është botuar për të parën herë nga edicioni i botimeve të revistës "Pionieri", Prishtinë 1967.

Me sa dimë "Fjalën paraprake të redaksisë" e ka shkruar prof. Anton Çetta, i cili ribotimin e kësaj vepre e pati nxitur dhe njëherësh këshilloi që me rastin e ribotimit mos të bëhen ndryshime të ndjeshme gjuhësore.

Uroj që edhe tashti leximi i kësaj vepre, qoftë nga prindërit, qoftë nga nxënësit e të tjerë të bëhet me ëndje, ashtu sikurse që pritur së paku për një pjesë lexuesish atëherë, kur qe botuar për të parën herë!

Prishtinë, qershor 1996

Autori

"Ishte njiherë..." Kështu duket se fillon kjo përmbajtje vjershash e thirrur "Miklime". Ishte përnjimend njiherë një foshnje që lindi dhe u rrit në gjinin e ambël e kujdesin e ngrohtë të nanës. Foshnja lindi, u zhagit, u çue në kambë, luejti, qeshi e nana i këndoi kangët e bukura të djepit.

E keni pa motrën a vllaun e vogël tue qeshë në gjum, tue ba guga, tue u halitë, tue i ra pjatës me lugë, tue luejtë me tezen, tue ju shtrëngue dorën apo tue ju kapë për hunde. Ju nuk idhnoheni sepse e dini se asht i picërr. Kështu asht foshnja e "Miklimeve".

Kur ta mbaroni së kënduemi kët libër keni me mendue një njome që rritet ngadalë dhe do t'ju duket sikur me e pasë shetitë edhe ju ose sikur me e pasë përkund edhe ju në djep. Ka me ju tingëllue në vesh qeshja e ambël e vocrrakut apo vaji, pse e nguci macja me bisht...

Qeshni e këndoni edhe ju bashkë me foshnjen që lindi në "Miklimet"

Redaksija

9

LINDJA E FOSHNJES

Sikurse ndër festa
qitni sot batare
pushk' e fyshekszare,

qitni se s' rrjedh jeta
këndshëm: mjalt e ar
pa trashëgimtar;

fyej e borizane
sharkia e trumpeta
rrihni, tungjatjeta,

se n' kët dit' të madhe
erdhi g'zimi i pritur
kërthiu ynë i mitur!

11

FOSHINJA QESH

Qeshu, qeshu njomëzë,
rrezja t' shkrepit në faqe;
qeshu, qeshu zogëzë,
zemrën ma kënaqe!

Foshnja qeshet, qeshet
rreze gëzimi shkep...
nëna ndan peshqeshet,
tambël¹ - jetë i jep!

¹) qumësht

PICIMULI TOPOLAK

Topolaku,
topolaku
duart me tul

është i vogël
shumë i vogël
-picimul.

Po kokrroshi
bukuroshi
përpëlitet

do vocërraku
topolaku
vrik të rritet!

KUMTIMBARDHI

Vallë, -
çka rrëfeu
tezja
për foshnjën
si rrezja?

"Shëndosh
si molla
n'gemb,
qenka
përnjimend"!

FOSHINJA QESHI NË GJUMË

Lum e lum
për gëzime shumë
foshnja
njomja
m'qeshi n' gjumë.

G'zim o g'zim,
për fatin tim,
rritmu
g'zohu,
shtalbi im!

Shëndetmirë
je për dëshirë
n' zhgandër
n'ëndërr
m'qeshesh dliirë.

MIKLIME

1

Çun o çun
topolak
rri në shpinë
ecën me bark.

Çun o çun,
synin rrush,
tatalush
mo' u përpush!

Pse ky çun
kryetullaci
shkon te nëna
s'vjen te baci?

16

2

Çuni, çuni
po na rritet
pakngapak
po halitet...

Fjala e parë:
"Nana, nana";
fjala e dytë:
"ama, ama"!

E zgjat dorën
s' do me pritë,
dhe pse s'di
me thënë: "simit"!

17

BEBJA TRASHALUQE

Trashaluqe,
faqekuqe,
po lulëzueke
si burbuqe!

Përmirësohu
e madhohu,
mirë stolisu
hijeshohu ...

moj guguqe
faqekuqe,
këndo, qeshu
trashaluqe!

18

BUZAVAJSI

Haj, haj, haj...
buza n' vaj!...
merre
thithën
e mos qaj!

Buzavajsi
shuk, shuk, shuk
e pi tamlin:
ngujk, ngujk, ngujk ...


-Bazavajsin
vallë, ç'e gjeti?!
-Me bisht
macja
pak e preki!...

19

NINA NIN

Nina nin
djaln trim!...

Shpejt na rritet
qet me pushkë,
e tut ujkun
larg në fushë.



20

Nina nin
çunin tím!...

Rritet, ntrashet
bëhet burrë,
shetit gjyshen
me veturë...

21

NINULE

Nina, nina
orlollo,
nina, nina
ninën-o!

Syt' e ninës
mbyllen shpejt,
tash e mori
gjumi lehtë.

Nina fle
ëndërron,
nënën gazi
e kaplon!

Nina, nana
orlollo
nina gjumin
shumë e do!

22

ÇUPA-ÇUP

Çupa-çup
në govatë
vocërr-vogli
po spërkat.

E lan nëna
e fërkon
syrrush djalthi
shumë gëzon:

Çupa-çup
llokoçit
me këmbëdoçka
kah lëvrit.

Guak-uak,
si rosak
dël nga uji
t'lozim pak.

Par mbas të lamit
çuni fjeti,
e mor gjumi
krahalehti!

23

VOGLI-GOGLI

A ta rraf
a ta qaf
voglin-o?

A ta dua
a mos ta dua
goglin-o!?

Voglin
s' e do
nëna,
së i qau
pa lot
kur e lau sot.

Goglin e do
babi,
se gël-gël
i qesh
kur e xiglon në vesh!...

Gogël-voglin
do ta qaf,
Vogël-goglin
nuk e rraf!

24

I NGJAU PAHIRI!

Ballashyti,
ballagjani
qan bërtet
thua se u bë nami!

Ballagjani,
ballashyti
qau me zë
sa ia nxu fyti..

Vallë, si thoni,
ç'e mundoi?!
-Thithën vetes
ia largoi!

25

RRITET BEBJA

Piqet dardha,
piqet molla,
rritet djalthi
si mënjolla.

Rritet shtalbi,
rritet njoma
dardhamjaltën
vë te goja,

rritet vogli
luan me mica
mollakuqen
bren me kica.

26

TRASHALUQI ME KAPUÇ

Sykapsoll,
trashaluq
i ke veshët
nën kapuç!

Tufa në maje
t' bën fër-fër,
se ç'po qeshesh:
gël-gël-gël!



27

ZGJIMI

Mejti shiu
rrezon dielli,
djali i nënës
sytë i çeli!

-Çka ëndërrove,
pse po qesh?
a do tambël
a përshesh?...

M' thuaj e shpihu,
zgjero shtatin,
se prap nëna
ta ndreq shtratin...

28

BËN ME GISHT

E çon dorën
bën me gisht,
largo f' tyrën
se se t'gërvisht.

E çon dorën
dhe kanoset:
qum'shti djalit
s'bën t'i soset.

Kur të flejë
zhurmë mos bani
se ngrëfuset
si bibani

dhe një këshillë
ju jep me gisht:
"Mos e kapni
macen n'bisht"!

29

SHUEJTËN PO E KËRKUEKA

Lidh e zgjidh
voglushin,
zgjidh e lidh
mikluesin...
s'qetësohet, s'pushon!

Si lazdran
ai shtiret
s'do të lidhet
as t' zgjidhet
vallë, çka dëshiron?

Kështu
s'po u durueka!
-Shujtën
mos kërkueka?!

Jepia sa më shpejt,

sepse
çunin tonë
gjumi
po e kërkon
me marrë n' krah't e vet!


30

FLI VOGËLUSHE

Fli vogëlushe
moj syrrushe,
mbyll qepallat
dëgjo përrallat...

Çdo fëmijë
kështu si ti,
bardh e bukur,
lehtë si flutur,
kur pi qumështin
kërkon gjumin,
ëndërron lule,
hidhet në lojë,
nis të këndojë...

31



32

MIRËMENGJESI

Mirëmengjesi,
si ke fjetë?
Paska çelë
lulja me fletë?



33

Mirëmengjesi,
qenke rritë,
nëpër terr
a nëpër dritë?

Pa na thuaj:
-sa të rriti gjumi,
sa një arrë
a 'i kokërr gruni?!

34

PËRPUSHET BEBJA

S'po e zë vendivend,
pëpushet gjithnji,
s' do në kokërr shpine,
as në bark nuk rri...

Ulur ia kënda
s' mund të rrijë, fare pak!
I luan dora - këmba
s' ecën asnjë hap.

Këmbët kalakryq,
përpushet, gaugulon
derisa qepallat
gjumi ia rëndon...

35

FLE GJUMASHI

Fle gjumashi,
mos e zgjoni
se vrënjitet n' fytyrë,

s'është lazdran,
ta besoni,
por nuk i vjen mirë,

sepse ëndrra
i ndërprehet
atbotë vetvetiu

dhe nuk qeshet
e nuk prehet
me gaz çilimiu!

36

DHËMBI I PARË

Sihariq,
sihariq,
o të dashur,
shokë e miq!

Mic-vogëlushit,
Kacelushit
si orizi
kokërrbardhë
na i doli
dhëmbi i parë!

Mic-kiclushi,
Kacelmici
m'duket gishtin
pak e kici!

Se tashmë
s'po e vë
në gojë
dhe nënokja
s'ka nevojë
t'ia largojë...

37

TUE MBAJTË PEZULL

I luan krahët
si shqiponjë,
shikon qiellin
nuk ka drojë
si piloti me përvojë...

A do të bëhet
djal' i urtë:
shkencëtar -
astronaut!

që të shfrytëzojë
nga krahët e dritës:
mrekullitë-
t'natës e t'ditës...

t'i sjellë botës
shpikje të rralla
që s'i njihnin
më përpara!

që s'i dinin
më përpara
që s'i flitnin
as n' përralla?!

38

FOSHINJA RRI ULUR

Eni shihnie
një çun-bablok,
kah rri ulur
e luan me kokë;

luan me kokë
mbahet me duar
shalakatet
si kaluar;

Vënia thithën
si çibuk
edhe mbështetësen
butë-pambuk,

se po druaj
mos trullohet
si prej kalit
mund t' rrëzohet!

39

MRROLAÇI

Mrrolaç djali
faqetuli,
a do të bëhet
ndojfar' burri?

A do të bëhet
ndojfarë trimi,
që shikon k'shtu
si hutini?...

S'po i ka hije
rrudha në ballë
dhe as loti
mbi qepallë!

40

ZGJO'U VOGËLUSHE

N' terr e veshur ikën nata
n' djep ëndrrash si pahitur,
oj gjumashe, ngre qepallat,
se mjaft fjete, qenke rritur!

Ngre'u, shih si vjen agsholi:
hapa-hupa, pup më pup.
tash në qiell bardhishka doli,
tash ndër male duket - fup!

Syri i dritës, po t'përshndetë,
mirëmëngjesin ta uron,
rrezja e bukur n'gaz po prekë,
bardh-kuq faqet t'i ngjyron.

Prandaj ngre'u, bëju herake
g'ëzo dhuratën mëngjesore!
Mos u shtir si shumë vocrrake
që s' ngrihen pa i kapë për dore!

41

ZHAG E HAPA HOPA

Zhag e hapa-hopa,
djali më këmbë t' vogla
jashhtë na paska dalë.

Dorën paska zgjatur,
hënën për ta kapur?!...

-Ç' po i kërkuaa vallë?!

-Rrezet me ia falë
që t'i shkrepin n'ballë!

42

HAPAT E PARË

Ec tue mbështetë,
rri pa u mbështetë
rushja jonë fatbardhë!

Njëherë tue u dridhë,
mandej pa u dridhë,
qet hapat e parë.

Ashtu pra...; Urime
Edhe shumë përgëzime,
se kryen punë të madhe!

Po i kemi lakmi
për hapat e rij
t'ecjes krenare.

Rrushja jonë fatbardhë,
kryen punë të madhe,
qet hapat e parë
të ecjes krenare!

43

ÇUNI KËPUT LULE

Tërë mundin e derdhi
djali tash po ecën
Dhe pranvera erdhi,

gjelbërimet po rijnë,
lule për me mbledhë
çuni dol' n' lëndinë.



44

-Paska, paska shumë!
Lule tue këputë
mos u lodh o çun!

Mos i shtjerë në gojë,
çoja nën's dhuratë,
të të falnderojë...

madje veten shlodhe:
thur e shtur kurorë,
me ato që mblodhe!

*
Të lumtë ajo dorë!

45

NË SHËTITJE

Në park t'qytetit
shkrepi rrezja,
ec karroca
s'ecën bebja.

g'zohen prindja,
qesh kërthia,
duart e vockëla
lëmon puhia.

Lëvrinë gjethet
qeshin lulet,
pisha e madhe
nuk përkulet...

Ec karroca
bebja flen,
cicron zogu
naltë, në gemb...

46

T'IA PREJMË THONJTË

Thonj ka daci,
ka urithi,
ka dhe bebja
se gërrithi.

Faqet, buzët
mund t'i gërrithë
edhe mamin n'gji
kah thithë!

Mulni pra,
nga ky rrezik
ta shpëtojmë
më vrik e vrik.

Si t'ia heqim
thonjtë, ndytësi,
do ta shtrojmë
një gosti!

47

DO TA QETHIM

Çelën lulet
në livadh,
festë e vogël
gëzim i madh...

Kumbon kënga
plot me afsh
e zgjon çunin
flok' mëndafsh.

Tërë shtëpia
flakron gëzimit:
do ta qesin
në rreze të diellit,

do t'ia qethim
flok't e rralla,
tash dhe pet'lla
na sjell halla!

48

NJËVJETORI I LINDJES

Sonte kemi
fest' të rrallë,
t' thrrasin miq
e këngëtarë.

Me ne, të gëzojë
trashëgimtari,
mbushi vjetin
sot fatbardhi.

Le ta shohë
farefisi,
sa është rritur
n' shtat, si lisi!

49

KUK'LLA E VOGËLUSHES

Kuklla ime
brumbullake
hundfasule
pak voglake
sygështenjë
mollzagjake.

Pul-pulaken
e mikloj,
shpesh e ndrydh,
n' tokë e lëshoj
ajo s' bën
as gëk me goj'!

prandaj unë
e dua shumë
e qes në djep
e vë në gjumë!



50

NË LUHAJË¹

Oj luhaçe
fërfëllizë,
fluturaçe
porsi mizë,

oj luhaçe
shalabute
prorë m' kënaçe,
kurr' s' më tute.

1) shilarës

51

KOLOVAJZA

N' ditë behari
n' kopsht, te druni,
kush flut' ruaka
si pëllumbi?

-Një voglushe
luan e rritet,
fluturimthi
kolovitet

me shilarsen
strofulloge
e çan ajrin
porsi zoge,

porsi zoge
si p' llumbeshë
Fluturakja
është trimmeshë;

52

para, mbrapa
fulikare:
l'kundet, tundet
s'trembet fare!



53

SI VJEN GJUMI?

A di, si vjen gjumi,
vallë a mos ka fletë,
mos e bjen pëllumbi
apo ai vjen vetë?

Ndoshta e sjell era
e lehtë si puhi,
apo shushurima
e shiut n' çati?

A vjen me zukatjen
e bulkthit këngëtar
që gjith nat' n e lume
këndon pa u ndalë?

Mos e sjell ninulla,
që Nan'okja vetë
ma këndon aq ëmbël
kur unë bie me fjetë?!

54

NIKOQIRJA

Pastroi vendin
miellin siti,
gatoi bukë
e pite qiti.

Bazagaz pret
mysafirë
dhe i gostit
si është më mirë.

-Hani, pini,
thot', sa të doni
ëmbëlsira,
qe, urdhëroni!

-Por ta dini,
jua them troç:
buka e voglës
është' lojë, lloç!?

55

FUQIMADHI

Pastron shtatin
bëhet paç,
ha pa naze
dhe spinaq;

çdo mëngjes
bën fizkulturë,
prandaj është
i fortë si burrë;

n'ajr të pastër
rend me çuna,
s'është përtac
joshet nga puna.

56

SI ZANUSHJA

Një vog'lushe
sydrenushe
mblidhte lule
në zabel,
vinte n' krye,
vinte n'bel
dhe stolisej
si zanushe,
kjo vog'lushe
hapdrenushe...

57

TRIMËRESHA

Jam e vogël
por trimneshë,
jam pa hile
merrnie vesh,

sepse territ
nuk i tutem
as acarit
s'i përulem,

me shilarse
n'ajr, nalt, çohem;
kaloj vigun
nuk frikohem,

afër pyllit
mbledh ca mana
dhe kryej punët
si m'thotë nana...

58

VJOLLCA

Eni shoqe
të shetisim
ndër ograja
të gjezdisim,

ta gjejmë vjollcën
t'bukrën lule,
që na përsh'ndet
me aq përulje,

që mban kokën
si e marrshme
dhe e shkep at
erë të kandshme.

59

MOLLË, MOLLË

Mollë, mollë
l'vrehollë,
kuq-kuqloshe
bukuroshe,
ëmbëlcake,
rumbullake!

60

DARDHASHITËSI

1

Dardha t'mira
merrni, blini,
sot është dita,
mos i lini!...

Qe, verdhoshe,
këto majhoshe,
mirni, lani
mandej hani,
nëse doni,
i qëroni!

2

Dardha, dardha:
ujëse, pikëse,
nguracajka,
turke, bishnje;

kokërrvogla,
kumbullore,
të llojlojshme
dhe vjeshtore!

61

PEMËTARI

Eni, eni
veç me pa:
pemë të mira
qe, ku ka:

vishnje, arra,
kum'lla të bardha,
po në daçit
mollë e dardha.

M'i dha kopshti,
m'i dha puna,
tash sa i vola
k'ëtu i pruna.

62

FATBARDHA ME ARRA

Unë fatbardha
kam shumë arra:
rakatoshe,
fortacake,
miralojse
cepagjate...

Luajmë ngrehcash,¹
ngrehim turqë,²
paratekash,³
nusengulë.⁴

Nxjerrim thelba
pulpulaqe,⁵
gjysa-gjela⁶
shijekëndëse...

1, 2, 3, 4 - lojra arrash
5. - thelbi i tërë
6. - gjysma e thelbit

63

FTONI VARUR

-Ftoni, ftoni,
briti Moni,
si e pa n'dhomë varë,
lëvoveverdhin,
ngjyrgjendin
seç u hodh me marrë...

-Mos u ngut
zemërbarut,
i tha nëna e vet,
e kam varë
ti me marrë
por ende është shpejt;

mos shpejto,
një kohë duro,
lëre der'sa t'ndriqet,
tash ka hije
por s'ka shije,
me kohë çdo gjë hiqet!

64

VRESHTARI

Fatmirosh
o ti vog'lush,
eja n'vreshta
të jap do rrush...

kalavesha
zgjidh për vjerrea
edhe pjeshka
si sheqerka...

Rrushi i kuq
e thanci i zi
a të pëlqejnë
ma thuaj ti?!

65

GJELI E VAJZA

-Gjel, gjel, kacagjel,
a po do një kokërr mel?
-Unë e dua po nuk më del...

-Gjel, gjel, kacagjel,
a po i do dy kokërra mel?
-Unë i ha... po nuk më del...

Gjel, gjel, kacagjel,
prite pra një thes me mel!
-T'falem nderit, mjaft më del...

Tash ta fal, një "kikiri!",
mori vashëz, bukuri.

66

AH KY GJELI KACAGJELI

Gjeli, gjeli, kacagjeli
s'do thërrime, kokërra meli!

Gjeli, gjeli, gjysmëgjeli
e zgjat qafën, k'qyr për seri!

Gjeli, gjeli, gjel-arapi
në dorë bukën f'mijës ia kapi!

Ah, bre, gjel, bre gjysagjel,
t'hift tërpija, o dembel,

dhe pulave ua merr kafshatën,
he n'qervish ta pafsha qafën!...



67

ZEMRIMI NË MACEN

Macë, macë
kalikacë,
mjaullece
tërpjajkë
bishtagjate
e lazdrajkë!

Pse ma pive
qumshin n' gotë,
pse ma hëngre
misht e ngrohtë
edhe shkove
ra në shtrat,
shtëresh gjumëse
krrat e krrat...

Je goj'keqe
sypaluske,
si s't'erdh' marre
moj hardhuckë!

68

Tjetër ditë
s' kam me të lënë,
ti përsheshin
me ma ngrënë
edhe qoftet
t'ngrohta i ha,
naze nënës
s'i bëj ma;

mandej shtrojnë
e çoj vetë,
bashkë me mua
s't'le me fjetë...

Ty, për bishti
minjt t'u varshin
dhe musteqet
t'i rumcallshin!

69

LEPRUSHBUTI

Leprush veshgjati
dridhet krahtati,
kur t'leh zagari
dhe e ndjek gjahtari,

por ky leprushbuti
s'druan nga voglushi,
se ia mori mollën,
kur ia lëpiu dorën.

Tash ikën voglushi
nga gryk's leprushi
dhe s'i qaset pranë
kur t'jetë tue ngranë.

70

BARESHA

Cucë baresha
sokolesha,
shkon me qingja
kah lëndina,
n'për zabele
shkon me dele...

71

DY VOGLORE

Dy voglore
moshatore
kuq si mollë,
laps fletore
n'krahqafore
me tojë t'hollë,
dorë për dore
nisen n' shkollë.

72

E VYEMJA

U veshja, u mbatha
dhe faqet i lava.

Thonjtë mirë i preva,
vetë flokët i kreha.

-Nëna ime e mirë,
tash, pra, lamtumirë!

sepse s'ka nevojë
dhe as vetë s'kërkoj:

me më kapë për dore
e me m' çue në foshnjore.

73

GËZIMI I NËNËS

Lumja unë
për gëzim që prita:
qe sahora
m'u rrit çika.

M'u bë çika,
kuq si mollë,
i erdh dita
me shkue n'shkollë.

Tash urime,
moj fatbardhë,
mësohu, rritu,
udhambarë!

74

SHKOLLARIT TË VOGËL

Lum, lum bëra,
lum bëj tash,
që m'u rrite
sa një pash;

m'u hijeshove
rreze-ar,
vishu, ngjishu
si shkollar;

Shko, mëso
dituri -
që do të sjellë
lumturi!

75

TREGO GJYSHE...

(Para se me fjetë)

Pse ti gjyshe
orë mbas orë,
s' del me luejtë
me topa bore?

pse s' po del
n' oborr me mue
dordolecin
m' e ndër tue?

Më thuej gjyshe
lokja ime...
m' thuej diçka
për flok' t' e thime.

atëherë kur
e re ti ishe
a fluturojshe
si dallëndyshe?

M' trego gjyshe
pa u mahitë
(nji t' vërtetë
due m' e dijtë):

76

N' ato rrudha
që i ke n' ballë
a mos m' shihet
ndonji prallë?

M' trego gjyshe
gjana shumë,
se po m' mbyllen
syt' për gjum.



77

KURRESHTARI

Pse majmuni s' flet me goj',
bora pse nuk është sheqer,
E pse macja gërrith me thonj?!
-do të ma thoni me njëherë?

Kuklla ime pse s' po rritet,
gjyshja pse po e lidh kryet,
edhe gjyshi po kollitet.
sa herë nis unë kështu me pyetë?!

78

LULJA E NËNËS

(amë e bijë)

-Mori lule, mori bijë,
kush ta dha këtë bukuri?

-Zemra jote, nënëdashni
lulë-saksi!...

-Moj lulëkuqe, je si rreze
ku e more këtë buzëqeshje?

-Paj nga prehëri, i diellit nanë
që e kam pranë.

-Lulebardhë kush t' mësoj me ditë
me erëzue e me shndëritë?

-Paj ngrohësia e nën-pranverës,
vatra e jetës!...

-Lulejete, moj lule gëzimi,
kur të josh, moj ngazëllimi?

-Kur po shkrihem në pëqafime
të nënës sime!

Nëna qeshi, krah' t' i çoi,
Çupa shpejt e përqafoi.

79

BUZËQESH JETA

Dielli rrezet
çdo ditë derdh,
uji nga krojet
gjithnjë rrjedh.

Bleron fusha,
bleron mali...
rrjedhin gëzimet
derdhet malli...

E vogëlushi
rritet shqim,
po i buzëqesh
jeta n'agim.

80

PËRMBAJTJA

Lindja e foshnjes, 11	T'ia prejme thonjtë, 47
Foshnja qesh, 12	Do ta qethim, 48
Picimuli topolak, 13	Njëvjetori i lindjes, 49
Kuntimbardhi, 14	Kuklla e vogëlushes, 50
Foshnja qeshi në gjum, 15	Në luhajë, 51
Miklime, 16	Kolovajza, 52
Behja trashaluqe, 18	Si vjen gjumi?, 54
Buzavajsi, 19	Nikoqirja, 55
Nina nin, 20	Fuqimadhi, 56
Ninule, 22	Si zanushja, 57
Çupa-çup, 23	Trimnesha, 58
Vogël-gogli, 24	Vjollea, 59
Ingjau pahiri, 25	Molla, molla, 60
Rritet bebja, 26	Dardhashitsi, 61
Trashaluaqi me kapuç, 27	Pemëtari, 62
Zgjimi, 28	Fatbardha me arra, 63
Ban me gisht, 29	Ptoni i varun, 64
Shujtën po e kërkueka, 30	Vneshtari, 65
Flij vogëlushe, 31	Gjeli e vajza, 66
Mirëmengjezi, 33	Ah ky gjeli kacagjeli, 67
Përpushet bebja, 35	Zemrimi në macën, 68
Flen gjumashi, 36	Lepurushbati, 70
Dhëmbi i parë, 37	Baresha, 71
Tue mbajtë pezull, 38	Dy voglore, 72
Foshnja rri ulur, 39	E vycmja, 73
Mrolaçi, 40	Gëzimi i nënës, 74
Zgjo'u vogëlushe, 41	Shkollarit të vogël, 75
Zhag e hapa-hopa, 42	Trego gjyshe, 76
Hapat e parë, 43	Kurreshtari, 78
Çuni këput lule, 44	Lulja e nënës, 79
Në shëtitje, 46	Buzëqesh jeta, 80

81